FLETUDHËZUES I PAKETIMIT:
Informacion për pacientin

ALCET

Tableta të veshura me film – 10 mg
(Cetirizinë klorhidrat)

Lexojeni me kujdes këtë fletudhëzues përpara se të filloni përdorimin e barit.
Ky bar mund të merret pa përshkrimin e mjekut. Megjithatë ju duhet të përdorni Alcet me kujdes për të patur rezultat më të mirë.
- Ruajeni këtë fletëudhëzues. Mund të keni nevojë ta lexoni përsëri.
- Pyesni farmacistin tuaj për informacione shtesë ose këshilla.
- Kontaktoni mjekun tuaj nëse simptomat përkeqësohen apo nuk përmirësohen pas 3 ditësh.
- Në qoftë se ndonjë prej efekteve anësore përkeqësohet ose në qoftë se vëreni ndonjë efekt tjetër anësor, që nuk përmendet në këtë fletudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

Në këtë fletudhëzues:

1. Çfarë është Alcet dhe përse përdoret
2. Përpara se të merrni Alcet
3. Si ta merrni Alcet
4. Efekte anësore të mundshme
5. Si ta ruani Alcet
6. Informacion i mëtejshëm

1. ÇFARË ËSHTË ALCET DHE PËRSE PËRDORET
Cetirizinë klorhidrat është lënda aktive e Alcet.
Alcet është një bar antialergjik.
Tek të rriturit dhe fëmijët 6 vjeç e sipër, Alcet indikohet:
- për qetësimin e simptomave nazale dhe okulare si pasojë e rinitit alergjik sezonal dhe atij vjetor;
- për qetësimin e pruritit kronik (urtikarien idiopatike kronike).

2. PËRPARA SE TË MERRNI ALCET
Mos merrni Alcet:
- në qoftë se keni sëmundje të rëndë të veshkave (pamjaftueshmëri të rëndë me klirens kreatinine nën 10 ml/min.);
- në qoftë se keni mbindjeshmëri ndaj lëndës aktive të Alcet, ndaj ndonjë prej lëndëve ndihmëse të tij, ndaj hidroksizinës ose ndaj derivateve të piperazinës (lëndë aktive të ngjashme që ndodhen në barna të tjerë).

Nuk duhet t'i merrni tabletat Alcet 10 mg:
●në qoftë se keni probleme të trashëguara lidhur me mostolerimin e galaktozës, me mungesën e Lapp laktazës ose përthithjen e keqe të glukozë-galaktozës.

Tregoni kujdes të veçantë me Alcet
Në qoftë se jeni pacient me pamjaftueshmëri renale, ju lutemi të këshilloheni me mjekun tuaj; në qoftë se është e domosdoshme do të merrni një dozë më të vogël. Doza e re do të përcaktohet nga mjeku juaj.

Në qoftë se keni probleme me urinimin (probleme të palcës së kurrizit ose probleme të prostatës apo fshikëzës së urinës), duhet të kërkoni këshillë nga mjeku juaj.

Në qoftë se jeni pacient epileptik ose pacient me risk për konvulsione, duhet të kërkoni këshillë nga mjeku juaj.

Nuk janë vërejtur ndërveprime që dyshohet të kenë ndikim të dukshëm midis alkoolit (në nivelin e gjakut prej 0.5 për mijë që i korrespondon një gotë vere) dhe cetirizinës së përdorur në doza normale. Megjithatë, si me të gjithë antihistaminikët e tjerë, rekomandohet të shmanget konsumimi i njëkohshëm i alkoolit.

Fëmijët
Mos ua jepni këtë bar fëmijëve nën moshën 6 vjeçare, sepse formulimi i tabletës nuk lejon rregullimet e nevojshme të dozës.

Testet e alergjisë
Nëse keni planifikuar teste për alergjinë, është e nevojshme të ndërpritet mjekimi disa ditë përpara, sepse Alcet mund të ndikojë në rezultat.

Marrja e barnave të tjera
Ju lutemi të kontaktoni me mjekun ose farmacistin tuaj në qoftë se jeni duke marrë ose keni marrë kohët e fundit barna të tjera, përfshirë ato të marra pa recetë.
Në sajë të profilit të cetirizinës, nuk pritet të ketë ndërveprime me barna të tjera.

Marrja e Alcet me ushqim dhe pije
Ushqimi nuk ndikon dukshëm në përthithjen e cetirizinës.

Shtatzënia dhe ushqyerja me gji
Këshillohuni me mjekun tuaj para se të merrni ndonjë bar.

Ashtu si për barnat e tjera, përdorimi i Alcet duhet të evitohet në gratë shtatzëna. Përdorimi aksidental i këtij bari nga një grua shtatzënë nuk pritet të dëmtojë fetusin. Megjithatë, administrimi i barit duhet të ndërpritet.

Ju nuk duhet të merrni Alcet gjatë ushqyerjes së foshnjes me gji, sepse cetirizina kalon në qumështin e gjirit.

Drejtimi i automjetit dhe përdorimi i makinerive
Në qoftë se keni ndërmend të drejtoni automjetin, të merrni pjesë në aktivitete me potencial rreziku ose të përdorni makineri, duhet të vëreni me kujdes përgjigjen tuaj ndaj barit, pasi në disa raste mund të shkaktojë marrje mendsh. Nuk duhet ta kaloni dozën e rekomanduar.

Në qoftë se jeni i ndjeshëm, mundet që marrja e njëkohshme e alkoolit ose agjentëve të tjerë depresivë të sistemit nervor të ndikojë në vëmendjen dhe aftësinë tuaj për të reaguar.

Informacione të rëndësishme për disa nga lëndët ndihmëse të Alcet
Ky bar përmban laktozë. Nëse ju është thënë nga mjeku juaj që keni intolerancë nga disa sheqerna, kontaktoni mjekun tuaj përpara se të merrni këtë bar.

3.SI TA MERRNI ALCET

Këto porosi janë të vlefshme, përvec rastit kur mjeku juaj ju ka dhënë udhëzime të ndryshme për përdorimin e Alcet.

Ju lutemi të ndiqni këto udhëzime, përndryshe Alcet mund të mos jetë plotësisht efektiv.

Tabletat duhet të gëlltiten me një gotë ujë.

Të rriturit dhe adoleshentët mbi 12 vjeç
10 mg (një tabletë) një herë në ditë.

Fëmijët nga 6 deri 12 vjeç
5 mg (gjysmë tablete) dy herë në ditë.

Pacientët me dëmtim mesatar në të rëndë të veshkave
Pacientët me dëmtim mesatar të veshkave rekomandohet të marrin 5 mg një herë në ditë.

Në qoftë se keni përshtypjen se efekti i Alcet është shumë i fortë ose shumë i dobët, flisni me mjekun.

Kohëzgjatja e trajtimit
Kohëzgjatja e trajtimit varet nga tipi, kohëzgjatja dhe ecuria e ankesave tuaja dhe përcaktohet nga mjeku juaj.

Në qoftë se keni marrë më shumë Alcet
Në qoftë se mendoni se keni mbidozim me cetirizinë, ju lutemi të informoni mjekun tuaj.

Ai do të vendosë më pas çfarë masash duhet të merren, nëse është e nevojshme.

Pas një mbidozimi mund të ndodhin efektet anësore të mëposhtme me një intensitet të rritur. Janë raportuar efekte anësore si: konfuzion, diarre, marrje mendsh, lodhje, dhimbje koke, shqetësime, zgjerim i pupilës, kruarje, nervozizëm, sedacion, përgjumje, mpirje, ritëm i shpejtë, jonormal i zemrës, të dridhura dhe mbajtje urinare.

Në qoftë se keni harruar të merrni Alcet
Mos merrni një dozë të dyfishtë për të plotësuar dozën e harruar.

Në qoftë se ndërprisni marrjen e Alcet
Rrallë mund të ndodhë që pruriti (kruarje e fortë) dhe/ose urtikaria mund të rikthehet nëse e ndërprisni trajtimin me Alcet.

Në qoftë se keni pyetje të mëtejshme mbi përdorimin e këtij bari, pyesni mjekun ose farmacistin tuaj.

4. EFEKTE ANËSORE TË MUNDSHME
Si të gjithë barnat e tjerë, cetirizina mund të shkaktojë efekte anësore, megjithëse jo çdokush i manifeston.

Shpeshtësia e efekteve anësore është përcaktuar si:
Të zakonshme: mund të ndikojnë deri në 1 në 10 pacientë,
Jo të zakonshme: mund të ndikojnë deri në 1 në 100 pacientë,
Të rralla: mund të ndikojnë deri në 1 në 1000 pacientë,
Shumë të rralla: mund të ndikojnë deri në 1 në 10000 pacientë,
Të panjohura: shpeshtësia nuk mund të vlerësohet nga të dhënat e disponueshme.

Çrregullime të gjakut dhe çrregullime limfatike:
shumë të rralla: trombocitopeni (nivele të ulta të pllakëzave të gjakut).

Çrregullime sistemike të përgjithshme:
të zakonshme: lodhje.

Çrregullime të metabolizmit dhe ushqyerjes:
të panjohura: rritje e oreksit.

Çrregullime kardiake:
të rralla: takikardi (rrahje shumë të shpejta të zemrës).

Çrregullime të syve:
shumë të rralla: çrregullime të akomodimit, shikim i turbullt, okulogiracion (sytë bëjnë lëvizje rrethore të pakontrolluara).

Çrregullime të veshit dhe labirintit:
të panjohura: vertigo (ndjesi rrotullimi ose lëvizjeje).

Çrregullime gastrointestinale:
të zakonshme: tharje goje, nauze,
jo të zakonshme: dhimbje abdominale, diarre.

Çrregullime të përgjithshme dhe probleme në vendin e administrimit:
jo të zakonshme: asteni (lodhje ekstreme), gjendje e keqe e përgjithshme
të rralla: edemë (enjtje).

Çrregullime të sistemit imunitar:
të rralla: reaksione alergjike, disa të rënda (shumë rrallë)
shumë të rralla: shok anafilaktik.

Çrregullime hepatobiliare:
të rralla: funksion anormal i mëlçisë
të panjohura: hepatit (inflamacion i mëlçisë).

Ekzaminime:
të rralla: shtim në peshë.

Çrregullime të sistemit nervor:
të zakonshme: marrje mendsh, dhimbje koke.
jo të zakonshme: parestezi (ndjesi jonormale në lëkurë)
të rralla: konvulsione, çrregullime të lëvizjes
shumë të rralla: sinkope (të fikët), tremor, përndryshim i shijes, distoni (kontraktim i zgjatur jo normal i muskujve)
të panjohura: amnezi (humbje e memories), dëmtim i memories.

Çrregullime psikiatrike:
të zakonshme: përgjumje
jo të zakonshme: axhitim
të rralla: agresion, konfuzion, depresion, haluçinacione, pagjumësi
shumë të rralla: tik nervor
të panjohura: mendime vetëvrasjeje, makthe.

Çrregullime renale dhe urinare:
shumë të rralla: eliminim jonormal i urinës (dizuri, enurezë)
të panjohura: mbajtje urinare.

Çrregullime të sistemit respirator:
të zakonshme: faringit, rinit.

Çrregullime të lëkurës dhe të indit të nënlëkurës:
jo të zakonshme: prurit, rash
të rralla: urtikarie
shumë të rralla: edemë, erupsion i shkaktuar nga barnat
të panjohura: pustuloza ekzantematoze e gjeneralizuar akute (AGEP) (rash i shoqëruar me flluska që përmbajnë pus), prurit (kruarje intensive) dhe/apo urtikarie pas ndërprerjes së mjekimit.

Çrregullime muskuloskeletike dhe të indeve lidhëse
të panjohura: artralgji (dhembje e artikulacioneve), mialgji (dhimbje muskulare).

Në qoftë se ju shfaqet ndonjë prej efekteve anësore të përmendur më sipër, ju lutemi të informoni mjekun tuaj. Ndërprisni marrjen e Alcet sapo shfaqen shenjat e para të një reaksioni mbindjeshmërie. Më pas mjeku juaj do të vlerësojë gjendjen dhe do të vendosë për masat e mëtejshme që mund të jenë të nevojshme.

Në qoftë se mendoni se keni efekte anësore që nuk përmenden në këtë fletudhëzues, ju lutemi të njoftoni mjekun ose farmacistin tuaj.

5. SI TA RUANI ALCET
Mbajeni larg fëmijëve!
Mos e përdorni Alcet pas datës së skadimit, e cila është e shënuar në paketim.
Ruajeni nën 25°C!
Ruajeni në paketimin origjinal.

6. INFORMACION I MËTEJSHËM
Çfarë përmban Alcet
Lënda aktive është cetirizinë klorhidrat.
Çdo tabletë e veshur me film përmban 10 mg cetirizinë klorhidrat.

Lëndët ndihmëse janë: laktozë monohidrat, celulozë mikrokristalore, glikolat natriumi i amidonit, kroskarmelozë natriumi, talk, stearat magnezi, Opadry® II i bardhë, i cili përbëhet nga alkoli polivinik, dioksidi i titanit, polietilenglikoli, talku.

Përmbajtja e paketimit
Kuti me 20 tableta të veshura me film.

Mbajtësi i Autorizimit për Tregtim dhe Prodhuesi:

PROFARMA sh.a.,
Rruga "Skënder Vila",
Tiranë, Shqipëri.
Tel.: +355 4 23 89 602

Ky fletudhëzues u rishikua për herë të fundit në Tetor 2023.

SPECIFICATION

CROPING AREA 15 x 25 cm

PAY ATENTION, all the layers are visible. If you have to print this document please check or uncheck the specific layers.